VENDIM
Nr.24, datë 26.3.2009

PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË OST SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa b të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa b, 13, 14 dhe 16 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.3.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

- Me vendimin nr.18, datë 9.3.2009, Bordi i Komisionerëve vendosi fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencës në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për shoqërinë "OST"sh.a.

- Paraqitjen e plotë të dokumentacionit nga OST sh.a. siç kërkohet nga "Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave".

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencat në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike për shoqërinë "OST" sh.a. për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta